



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

P | **VENDIM**

Nr. _____, datë _____. 2025

PËR

**MIRATIM TË "PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE PËRBALLIMIN E
SITUTAVE TË ZJARREVE GJATË SEZONIT TË VERËS NË SIPËRFAQE PYJE-
KULLOTA NGA DREJTORIA PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN
NË BASHKINË GJIROKASTËR"**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nën-pika 1.1, shkronja "b", nenit 29, pika 2, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", Ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Ligjit nr. 45/2016, "Për vullnetarizimin", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë materialin bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar.

KRYETAR

Merita ISARAJ

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI

P/ VENDIM

Nr. ____ datë _____.2025

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMI E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK- NDIHMËN EKONOMIKE DERI NE 6% PËR MUAJIN MAJ 01-31.05.2025.

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597, date 04.09.2019 për “Për Përcaktimin e Procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë, me propozim të kryetarit të bashkisë Gjirokastrë;

VENDOSI:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Maj 2025, 6 (gjashtë), individë/ familje me fond **22,531 lekë**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KËSHILLIT
MERITA ISARAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

P/V E N D I M

Nr ____ datë _____.____.2025

PËR

**“PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE(INDIVIDËVE/FAMILJEVE) PËR
SUBVENCIONIN E KREDISË SË BUTË FINANCIAR NGA FONDET E BUXHETIT TË
SHTETIT DHE BASHKISË GJIROKASTËR 2025 ”**

Në mbështetje të nenit 24, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 47, për “Subvencionin e interesave të kredive”, nenit 48, “Përfituesit nga Programi me kosto të ulët”, nenit 16 për “Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve”, të Ligjit nr.22/2018, “Për Strehimin Social” ,i ndryshuar, VKM-së, Shkresës Nr.15406 datë 06.12.2024 nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Strehimit dhe VKM Nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të srehimit dhe te afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës _____.____.2025

V E N D O S I:

1. Të miratojw listën e përfituesve individ/familjeve për ”Subvencioni i Interesave të Kredisë” sipas Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Gjirokastrë.
2. Të miratoj procedurën për zbatimin e programit social të strehimit “Subvencioni i Interesave të Kredisë” sipas Buxhetit të Shtetit dhe Buxhetit të Bashkisë Gjirokastrë, hartuar sipas udhëzuesit operacional, me vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 65, datë 02.10.2024
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, Sektori i Shërbimeve Publike, Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve Publike, Sektori Juridik, Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes së tij.

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI

P/VENDIM

Nr. __ date __. __. 2025.

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
BASHKISË PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE
PËR MUAJIN MAJ 01-31.05.2025.**

Në bazë të Ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, vendimit Nr 85 datë 10.02.2021, si dhe bazuar në Udhëzimi nr.4 datë 17.02.2017 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pika 7, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjit 68/2017 “Mbi Financat e Vetëqeverisjes Vendore” VKB nr. 86 datë, 12.12.2024 për “Për Miratimin Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025” është miratuar fond “Ndihma Ekonomike” me fond limit 2.000.000 lekë/vit, Këshilli i Bashkisë Gjirokastrë;

VENDOSI:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Maj 2025, 46 individë/ familje me fond 138,362 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore), si dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT
Merita ISARAJ